



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

## LICENCË PËR PRODHIM TË ENERGISË ELEKTRIKE

DHËNË :

**KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS SH.A**

**Divizioni i Gjenerimit, TC Kosova A**

**Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li\_05/13\_A**



## PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS .....	5
Neni 1: Përkufizimet.....	5
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Prodhimit .....	6
Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve .....	7
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit .....	7
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji .....	7
Neni 6: Sigurimi i rezervave të lëndëve djegëse .....	7
Neni 7: Dispeçingu Qendror .....	8
Neni 8: Shërbimet Ndihmëse .....	8
Neni 9: Caktimi i Operatorit .....	9
Neni 10: Rregullat e Tregut .....	9
Neni 11: Shëndeti dhe Siguria .....	9
Neni 12: Mjedisi .....	9
Neni 13: Puna .....	10
Neni 14: Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit.....	10
Neni 15: Obligimi i Sigurimit.....	10
Neni 16: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit .....	10
Neni 17: Obligimet e Shërbimit Publik.....	11
Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së .....	11
Neni 19: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	12
Neni 20: Taksat.....	12
Neni 21: Masat Administrative dhe Gjobat .....	12
Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve.....	12



## KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE")**, në pajtim me autoritetit e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184), Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L – 201) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, **i vazhdon edhe për një vit (deri më 04.10.2015) Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK SH.A") SH.A-Divizionit të Gjenerimit (tani e tutje "i Licencuari")**, Licencën për gjenerim të energjisë elektrike nga centrali gjenerues **Kosova A**.
2. Kapaciteti nominal (i instaluar) i Njësive Gjeneruese të Kosova A është: njësia A1- 65 MW, A2 - 125 MW, A3 - 200 MW, A4 - 200 MW, A5 - 200 MW.
3. Kapaciteti aktual në disponim i Njësive Gjeneruese është: njësia A1-0 MW, A2- 0 MW; A3 – 135/115 MW; A4 –135/115 MW; A5 – 135/115 MW.
4. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
5. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energji Elektrike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
6. Nga i Licencuari kërkohet që t'i ofrojë furnizuesit publik energjinë elektrike me çmim të rregulluar, të prodhuar nga centralet e veta elektrike, në përputhje me Nenin 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
7. Pas plotësimit të obligimeve të furnizimit publik të përcaktuar me këtë Licencë, i licencuari mund ta shes energjinë elektrike që e prodhon nga centrali i tij elektrik me çmime të negociuara si në vijim:
  - 7.1. konsumatorëve të kualifikuar nëse Prodhuesi ka licencën për Furnizim të lëshuar nga ZRRE;
  - 7.2. konsumatorëve jashtë territorit të Kosovës;
  - 7.3. tregut të brendshëm apo rajonal të shkëmbimit të energjisë elektrike; dhe
  - 7.4. furnizuesit publik dhe furnizuesve tjerë.
8. Në përputhje me nenin 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike, obligohet i Licencuari që të importoj energji elektrike për plotësimi e nevojave të konsumatorëve të pakualifikuar, në periudhat kohore kur prodhimi vendor është i pamjaftueshëm, dhe kur në mungesë të këtyre importeve, konsumatorët do t'i nënshtrohen shkyçjeve në Kosovë. Ky obligim do të shfuqizohet më së voni me 1 Janar 2015.
9. Në përputhje me kërkesat e Legjislacionit në fuqi dhe kësaj licence, i Licencuari do ta menaxhojë në mënyrë më ekonomike centralin e gjenerimit të energjisë elektrike, si në vijim:

